VENDIM
Nr.6, datë 20.10.2006

PËR PLANIN PËR DHËNIEN E NDIHMËS SHTETËRORE SHTËPISË BOTUESE "NAIM FRASHËRI"

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2006, shqyrtoi raportin "Për planin për dhënien e ndihmës shtetërore shtëpisë botuese "Naim Frashëri"". Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me shkresën nr.8987, datë 14.9.2006 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.1, datë 19.9.2006.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, mbështetur në nenin 4 dhe nenin 22 pika 2 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore",

VENDOSI:

1. Të mos miratojë planin për dhënien e subvencionit shtëpisë botuese "Naim Frashëri" për financimin e projektit "Botimi i veprës dramatike të Gjergj Fishtës", pasi ai përbën ndihmë shtetërore të ndaluar.
2. MTKRS, për vënien në zbatim të projekteve për botimin e veprave të tilla të trashëgimisë kulturore, duhet të ndjekë procedurat e prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli